

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E HËNË 11 PRILL 2022

Të premten e fundit, domethënë para dy ditësh, rreth 590 pasagjerë, turistë, zbritën në portin e Sarandës me kroçeren e parë, e cila quhej “Silver Moon”, dhe në njëfarë mënyre hapi turizmin që na vjen nga deti. Kurse të shtunën, një ditë më pas, rreth 100 turistë të tjerë zbritën në portin e Durrësit me një kroçere tjetër, që quhej “Bukuroshja e Adriatikut”. Dy elementet e fundit, pa përmendur shifra të tjera, tregojnë që sezoni turistik ka filluar, me gjithë krizën që po e shoqëron këtë sezon në mënyrë shumë të çuditshme, sigurisht, me pasojat e veta, si në të gjithë botën. Po bëhemi gati për këtë sezon duke u përballuar edhe me krizat, por tashmë kemi mësuar t’u përshtatemi situatave të paparashikuara që na vijnë nga natyra, nga krizat shëndetësore apo nga kriza të tjera globale.

Jemi në terren çdo ditë, çdo javë për ta përgatitur sezonin, por, përtej bukurive të trashëgimisë kulturore, përtej mikpritjes, çfarë do t’u tregojmë ne tjetër turistëve, të cilët, në fakt, i duam të shumtë, i duam cilësorë, i duam të paguajnë sa më shumë lekë, të lënë sa më shumë lekë dhe, në këmbim të kësaj, sigurisht, ata kërkojnë më shumë shërbime dhe më shumë standarde?! U tregojmë natyrën; natyrën siç na e ka dhënë Zoti apo edhe natyrën, siç e trajtojmë ne. Në punët që bëjmë çdo ditë në terren, në një nga inspektimet që bëjmë para pak kohësh me ekipin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe me përfaqësues të Bashkisë së Sarandës dhe të asaj të Finiqit në punimet e rikualifikimit të projektit, që po mbaron, në parkun natyror të Syrit të Kaltër, teksa i mburreshim njëri-tjetrit apo vetëdijes sonë me perlën e natyrës, ujin qelibar, pamë se bluja e ujit bëhej pis nga një kanoçe e ngecur pas një guri, e cila me siguri kishte ngelur aty që nga sezoni i kaluar turistik.

Nuk ishte as hera e parë dhe as e fundit, sidomos gjatë Planit Kombëtar të Pastrimit, që kemi nisur që në muajin nëntor, sepse e kemi nisur herët përgatitjen për këtë sezon, kemi parë pamje të tilla, madje edhe më të tmerrshme, në natyrë, në mjedis, në vijat e ujit, në pyje. Por ajo kanoçe ka edhe një simbolikë: kalimin me shpejtësi, sa hap e mbyll sytë, në konsumim që, pa e vrarë aspak mendjen, të magjepsur nga mundësia e lirisë së zgjedhjes dhe të blerjes, ne zgjodhëm këtë mundësi për të mbushur territorin me plastikë lara-lara, me qese që varen pemëve, me plehra që, pavarësisht se mendonim se po ia fshihnim syrit, duke i nxjerrë nga pragu i derës së shtëpive tona, të cilat i mbajmë xixë (në fakt, unë mund t’ju tregoj edhe të tjera), janë të trashëguara prej 30 vjetësh, por ju nuk mund t’i dini, se jeni mjaftueshëm e re. Kështu që është mirë të na dëgjoni ne që kemi njohur edhe atë epokë, edhe këtë tjetrën. Çfarë kemi bërë në këta 30 vjet? Kemi vënë në rrezik tokën, ujin, shëndetin tonë, shëndetin e fëmijëve tanë, me një ndërjegjësim shumë të ulët.

Përtej ngjyrave të bukura të ambalazheve, të cilat na hutuan sytë në varfërinë dhe në tranzicionin e tmerrshëm të viteve 90-të, në padijen e viteve 2000-2010, tani që flasim gjithmonë e më shumë për mjedisin, kemi kuptuar se çfarë është vërtetë prioriteti, sidomos prioriteti i mandatit të tretë, si një rrjedhë logjike e arritjeve të të dyja mandateve të para, pasi ringritëm hapësirat urbane, infrastrukturën shëndetësore dhe arsimore, shëndoshëm financat, sidomos planifikuam territorin, që e gjetëm

katrahurë nga të gjitha anët, pa kokë e pa këmbë, pavarësisht nëse ishin në zonë natyrore të mbrojtur apo në zonë trashëgimie kulturore dhe ja ku jemi.

Kjo forcë politike ka vizionin të ndërtojë sot programe, që nuk punojnë as për një vit dhe as për një mandat; kjo forcë politike ka vizionin të rregullojë dhe të shërojë plagët e një tranzicioni të zgjatur, por të punojë edhe për Shqipërinë e viteve 2030 dhe për gjeneratën e fëmijëve, që janë sot fëmijë, por që nesër do të jenë të rritur dhe nga vendimet tona varet e ardhmja e tyre. Ky është zhvillim; kjo është përkujdesje dhe kjo që bëjmë sot është siguri. Prandaj e çuam përpara këtë nismë shumë të domosdoshme, e cila nga konsultimet me publikun doli po aq e dëshiruar nga qytetarët: ndalimin e qeseve plastike njëpërdorimshme, pikërisht të atyre qeseve që përhapen me shpejtësinë e erës kudo në territor, të cilat i përdorim me lehtësi, sa herë duam të blejmë dy kokrra domate apo një kokërr qepë. Duke iu referuar ligjit që ne miratuam me shumicë lavdëruese votash më 17 mars, ku sërish përfitoj nga rasti t'i falënderoj kolegët e opozitës, të cilët e votuan ligjin në emër të mjedisit, të shëndetit dhe të ardhmes, dua t'ju them se ndryshimet ligjore, të cilat i miratuam me mbi 80 vota, hyjnë në fuqi më 1 Qershor, ditën e fëmijëve. Ky është vetëm hapi i parë drejt reduktimit të plastikës njëpërdorimshme në të përditshmen tonë.

Kur e nisëm Planin Kombëtar të Pastrimit nga qyteti i Vlorës, e dinim që s'do të ishte aspak e lehtë, s'do të ishte as aksion dhe as një ditë klasike vullnetarësh pastrimi, por do të ishte një punë e përditshme në terren. Gjatë gjithë këtyre muajve kemi marrë shumë mesazhe, duke filluar që nga rrjetet sociale e deri në takimet që kemi bërë, të tipit si: "Ndëshkojini dhe gjobitini ata që ndotin!". Patjetër që do ta bëjmë! Ne risollëm në vëmendje një nen të harruar të ligjit, atë të krimit mjedisor, duke e përfshirë edhe në aplikacionin "Komisariati digjital". Të gjitha fotot, videot, shfryrjet, ankesat dhe denoncimet, që pushtojnë rrjetet sociale, gjejnë pasqyrim në "Komisariatin digjital" Konfirmimi tjetër na erdhi pikërisht nga Këshillimi Kombëtar, ku 77 % e të pyeturve konfirmuan se duan të ndëshkohet më shumë krimi mjedisor dhe të rriten sanksionet, e cila, në fakt, është detyra jonë e menjëhershme. Paralel me zbatimin e ligjit për ndalimin e qeseve plastike, ne do të forcojmë edhe nenet për rastet e ndotjes së mjedisit, në emër të jetës. Edhe një herë dua të theksoj se nuk e kemi tokën trashëgimi, ua kemi marrë borxh fëmijëve tanë. Prandaj, të gjithë bashkë, siç e votuam atë ligj, edhe me mjetet e edukimit dhe të komunikimit t'ua kthejmë fëmijëve tanë pastër.